



A.nr.515/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.515/2026, të datës 08.05.2026, të parashtruar nga ankuesi F.Q, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike-administrative “*transferim i përhershëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 17.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.515/2026, e datës 08.05.2026, e parashtruar nga ankuesi F.Q.
- II. Shfuqizohet** Vendimi me numër protokoli 2426/26, i datës 06.05.2026, i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- III. Obligohet** ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që në zbatim të këtij vendimi dhe brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit të me numër protokoli 6560/25, të datës 02.09.2025, më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil F.Q (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 08.05.2026, përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër protokoli 2426/26, të datës 06.05.2026, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak të shkeljeve ligjore dhe

procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.05.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2245/2026 të datës 08.05.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin numër protokolli 2426/26, të datës 06.05.2026, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Akt Emërimit të datës 02.09.2025 të ankuesit; Vendimin me numër protokolli 2449/2026 të datës 07.05.2026 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore; Autorizimin e datës 07.05.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.05.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2026; Emailin e datës 12.05.2026 nga B.F për ankuesin; Emailin e datës 12.05.2026 nga ankuesi për B.F dhe H.K; Emailin e datës 08.05.2026 nga përfaqësuesi i ankuesit për B.K; Emailin e datës 19.05.2026 nga B.K për G.K; Vendimin me numër protokolli 2503.26 i datës 12.05.2026; Emailin e datës 30.04.2026 nga ankuesi për H.K; Emailin e datës 28.04.2026 nga B.K për ankuesin; Emailin e datës 28.04.2026 nga ankuesi për B.K; Emailin e datës 28.04.2026 nga B.K për ankuesin; Sqarim i datës 16.04.2026 nga Departamenti Ligjit i MDAP; Kërkesën për interpretim ligjor e datës 26.03.2026 nga G.K për F.D; Emailin e datës 21.04.2026 nga ankuesi për B.K; Emailin e datës 14.05.2025 nga ankuesi për F.B etj; Emailin e datës 13.05.2025 nga F.S për ankuesin; Emailin e datës 13.05.2026 nga ankuesi për F.S.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

I. Gjendja e Çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 6560/25, të datës 02.09.2025, mban pozitën Drejtor i Autoritetit të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më Vendimin numër protokolli 2426/26, të datës 06.05.2026, ka transferuar në mënyrë të përhershëm ankuesin nga pozita Drejtor i Autoritetit të Pellgjeve Lumore në pozitën Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit numër protokolli 2426/26, të datës 06.05.2026, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke pretenduar se vendimi i atakuar është në kundërshtim me nenin 47, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.4, nenin 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 65 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse, transferimi i përhershëm është bërë pa pëlqimin e tij. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet akti i kontestuar me ankesë dhe të obligohet autoriteti punëdhënës që ta kthej në vendin e punës sipas akt emërimit.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa referuar objekti të ankesës, Kolegji i Këshillit për trajtim të drejtë dhe meritore të çështjes mori parasysh:

- I. Nenin 65 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 2. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. 4. Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.***
- II. Nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet: ***1. Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. 2. Për rastet kur nëpunësi civil është i nivelit të ulët, mesëm apo të lartë drejtues, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 3. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër që punëson nëpunës civilë. 4. Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil.***

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kontestuar gjegjësisht Vendimin numër protokolli 2426/26, të datës 06.05.2026, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më të cilin ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershëm e për interes të institucionit në pozitën Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se akti i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me kërkesat ligjore për transferim të përhershëm të nëpunësit civil, sepse transferimin i përhershëm i ankuesit sipas akti të kontestuar është bërë pa pëlqimin dhe vullnetin e tij, si një nga elementet bazë të parimit të sigurisë juridike.

Andaj, duke qenë se Vendimi numër protokolli 2426/26, i datës 06.05.2026, i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është nxjerr pa plotësim të kriterëve ligjore, i njëjti konsiderohet akt i nxjerr në kundërshtim me ligjin material me konkret nenin 65 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 11 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe mbi këto të gjetura cilësohet akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa më sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.515/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;
- MMPH: u.d Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë për Burime Njerëzore në MMPH; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së